



REPUBLIKA E MAQEDONISË
MINISTRIA E EKONOMISË

Në pajtim me Programën për konkurrencë, inovacion dhe sipërmarrësi për vitin 2016 („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 2/2016), Ministria e Ekonomisë shpall:

THIRRJE PUBLIKE

për subvencionimin e ndërmarrjeve private për trajnim të HACCP ekipit për zbatim, mirëmbajtje dhe modifikim të HACCP sistemit

1. Lëndë e thirrjes publike është përkrahja financiare e trajnimit të ekipit HACCP për aplikim, mirëmbajtje dhe modifikim të sistemit HACCP.

Në pajtim me pjesën II, A – PËRKRAHJA DHE ZHVILLIMI I NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME, masa 4. Përkrahje financiare për trajnim të HACCP ekipit për zbatim, mirëmbajtje dhe modifikim të HACCP sistemit nga Programi për konkurrencë, inovacion dhe sipërmarrësi për vitin 2016 („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 2/2016“), për këtë masë janë paraparë mjete në vlerë prej 300.000 denarë.

Për realizimin e kësaj mase Ministria e Ekonomisë ndanë mjete financiare për trajnimin e tre personave të ndërmarrjes private, me çrast për çdo person të trajnuar do të ndahen mjete në vlerë prej 20.000 denarësh.

2. Të drejtë për pjesëmarrje në thirrjen publike kanë:

- ndërmarrjet private të cilat merren me veprimtari prodhuese në industrinë e ushqimit apo me veprimtari hoteliere (restorante dhe hotele),
- ndërmarrjet private të cilat nuk kanë fituar subvencione gjatë vitit 2014 dhe 2015 në bazë të këtij qëllimi.

3. Dokumentet e nevojshme për paraqitje:

- Formular të plotësuar “Kërkesë - HACCP 2016” (mund të merret nga arkivi apo nga ueb faqja e Ministrisë së Ekonomisë www.economy.gov.mk);
- Formulari i plotësuar „ Deklaratë – 2016 “ , e vërtetuar te noteri (Deklarata nga kërkuesi për ndarjen e ndihmës shtetërore, mund të merret nga arkiva ose ueb faqja e Ministrisë së Ekonomisë www.economy.gov.mk);
- Gjendja rrjedhëse nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë, jo më e vjetër se 2 (dy) muaj;
- Vërtetim për tatime dhe kontribute të paguara nga Drejtoria për të Hyrat Publike e Republikës së Maqedonisë, jo më e vjetër se 2 (dy) muaj;
- Marrëveshje midis kërkuesit dhe shtëpisë konsulente për trajnimin të HACCP ekipit për zbatim, mirëmbajtje dhe modifikim të sistemit HACCP, lidhur gjatë vitit 2015 ose 2016 (data e Marrëveshjes të jetë para datës së çertifikatës së lëshuar). Nëse shtëpia konsultuese është nga jashtë, Marrëveshja duhet të jetë e përkthyer në gjuhën maqedonase nga përkthyesi i autorizuar gjyqësor;
- Çertifikatë e lëshuar në vitin 2015 ose 2016 nga shtëpia konsulente;
- Faturë/a nga shtëpia konsulente;
- CV nga trajnuesit të akredituar në përputhje me Ligjin për arsim të lartë dhe Ligjin për arsim të të rriturve;

- Çertifikatë nga banka depozituese apo SWIFT në të cilin shihet se subjekti afarist tërësisht e ka kryer obligimin e tij ndaj trupit çertifikues në pajtim me Marrëveshjen;
- Fletpagesë me vlere prej 300,00 denarë (Qëllimi i pagesës:pagesë për taksa administrative, Pranues: Buxheti i RM, Llogaria e trezorit:100000000063095, Llogaria:840___(varësisht nga komuna) 06116, Kodi i të hyrave dhe programa:72593000).

Dokumentacioni i lartëpërmendur dorëzohet në origjinal ose kopje.

Nëse dokumentacioni dorëzohet kopje, besueshmërinë e e dokumentacionit aplikuesi i kërkesës e vërteton me nënshkrim dhe vulë të vetën në secilën faqe të kërkesës.

Thirrja publike është shpallur në ueb faqen e Ministrisë së ekonomisë www.economy.gov.mk dhe në www.konkurentnost.mk

Kërkesat për subvencionim i shqyrton Komisioni i formuar nga Ministri i Ekonomisë.

Zgjedhja e aplikuesve të cilët i plotësojnë kushtet të parapara me thirrjen publike do të bëhet në përputhje me parimin „I pari vjen i pari shërbehet”, respektivisht sipas dorëzimit të aplikacionit, deri në harxhimin e mjeteve në dispozicion.

Një aplikues mund të shfrytëzojë subvencion vetëm njëherë nga shpallja e thirrjes publike.

Kërkesat me dokumentacion të kompletuar, duhet të dorëzohen në Arkivin e Ministrisë së Ekonomisë, rr. „Jurij Gagarin” nr. 15, Shkup, **deri më 31.05.2016**

rel: (02) 3093 525; (02) 3093 508
